VENDIM
Nr. 70/2014

PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR SHKARKIMIN E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË LARTË TË DREJTËSISË TË ZGJEDHUR NGA KUVENDI, Z. ELVIS ÇEFA DHE Z. LULZIM LELÇAJ

Në mbështetje të neneve 4, pika 1, 78 dhe 147, pika 1, të Kushtetutës, vendimit nr.75/2002, nr. 18/2003 dhe nr.26/2006 të Gjykatës Kushtetuese, ligjit nr. 8891, datë 2.5.2002, "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" dhe nenit 114 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Ngrihet Komisioni Hetimor Parlamentar për shqyrtimin e kërkesës së një grupi deputetësh me objekt "Shkarkimin e anëtarëve të Këshillit të Lartë të Drejtësisë të zgjedhur nga Kuvendi, z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj, për shkelje të rëndë të ligjit".

II. Komisioni Hetimor Parlamentar ka për objekt të verifikojë dhe të hetojë zbatimin e ligjit mbi të dhënat, faktet dhe rrethanat e pretenduara, si dhe të konkludojë nëse ekzistojnë ose nuk ekzistojnë shkaqet për shkarkimin e z. Elvis Çefa dhe z. Lulzim Lelçaj nga detyra e anëtarit të Këshillit të Lartë të Drejtesisë, të zgjedhur nga Kuvendi.

III. Komisioni përbëhet nga 9 anëtarë, 5 nga shumica parlamentare dhe 4 nga pakica parlamentare. Kryetari i komisionit i takon grupimit nismëtar të deputetëve. Përbërja e komisionit është si më poshtë:

1. Armando Subashi Kryetar - PS
2. Taulant Balla Anëtar - PS
3. Ulsi Manja Anëtar - PS
4. Besnik Baraj Anëtar - PS
5. Spartak Braho Anëtar - LSI
6. _____ _____Zv/Kryetar - Opozita
7. _____ ____Anëtar - Opozita
8. _____ ____Anëtar - Opozita
9. _____ ____Anëtar - Opozita

IV. Komisioni do ta zhvillojë veprimtarinë e tij brenda afatit 1-mujor nga data e miratimit të këtij vendimi.

V. Ngarkohet Kryetari i Kuvendit të autorizojë Sekretaren e Përgjithshme të Kuvendit të krijojnë kushtet e nevojshme logjistike për veprimtarinë e këtij komisioni.

VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar më datën 25.9.2014